



Hapet thirrja për mobilitete (bursa) studentësh të UPT-së, në kuadër të Marrëveshjes KA1, në University of Westminster, Angli

Në kuadër të Marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, në University of Westminster.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve të nivelit Bachelor për studime.

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- **Bachelor** (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Bachelor në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe të kenë përfunduar një vit studimi.)

Kohëzgjatja e bursave:

- 1 semestër (Janar – Maj 2022). Semestri ka 30 kredite - 10 ECTS/class.

Fusha e studimit:

- Computer Science

Numri total i studentëve: 3 studentë

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët Bachelor:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit, në shqip dhe në anglisht i noterizuar;
- Listë notash e studimeve Bachelor, deri në momentin e aplikimit. (Mesatarja e notave duhet mbi 7. (Të vërtetohet me listë notash.) Në shqip dhe në anglisht e noterizuar;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Certifikatë e gjuhës së huaj*;



**Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze, ku niveli minimal i kërkuar është B2. (Preferohet niveli C1, IELTS.) Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar, duke e vërtetuar me certifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në University of Westminster, lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvillonit lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Për të shkarkuar katalogun e moduleve të Computer Science, në nivelin Bachelor, për semestrin e dytë, Janar – Maj 2022 dhe ekuivalentimin e krediteve, ju lutemi klikoni këtu:

[Module Catalogue UGEXCH COMENG SEM2 2021/2 \(westminster.ac.uk\)](http://www.westminster.ac.uk/module-catalogue-ugexch-comeng-sem2-2021-2)

Për mënyrën e aplikimit, kërkesat akademike, informacionin për modulet dhe kreditet, si dhe informacione të tjera në lidhje me University of Westminster, ju lutemi klikoni këtu:

www.westminster.ac.uk/international/student-exchanges/how-to-apply

Dorëzimi i dokumentave të nevojshme për aplikim kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT, **brenda datës 27 Gusht 2021**.

Studentët që do të nominohen, do të kontaktohen me email nga University of Westminster, brenda muajit Shtator 2021. Këta studentë, duhet të kryejnë aplikimin online, sipas emailit të ardhur, **brenda datës 15 Tetor 2021**.

Për t'u informuar në lidhje me udhëzuesin e aplikimit në PDF, ju lutemi klikoni këtu.

[Incoming Exchange Student User Guide to Making an Online Application \(westminster.ac.uk\)](http://www.westminster.ac.uk/incoming-exchange-student-user-guide-to-making-an-online-application)

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: rkodra@upt.al dhe abego@upt.al